


Valentina Saraçini

Gazetare dhe këngëtare



Në foto: Valentina Saraçini

Nga arkivi personal i Valentina Saraçinit

Atëherë, unë quhem Valentina Saraçini. Me profesion jam gazetare, shkrimtare, por në rininë time kam qenë edhe këngëtare e muzikës së lehtë, pranë produksionit të Radio-televizionit të Prishtinës. Jam e lindur në Shkup, në vitin, më 28 shtator të vitit 1962. Shkollën fillore e kam kryer në Shkup, shkolla "Vllazërimi" është quajtur. Shkollën e mesme, përkatësisht gjimnazin "Zef Lush Marku" po ashtu e kam përfunduar në Shkup dhe kam regjistruar fakultetin e Psikologjisë. Ndërkohë që në vitin '80, në "Akordet e Kosovës" të vitit 1980 unë kam qenë debutante edhe kam kënduar një këngë të Veton Berishës edhe kam fituar "Okarinën e Artë".

<<< Pjesë e shkëputur nga kënga e Veton Berishës "Mbi Det" interpretuar nga Valentina Saraçini >>>



Vendi i parë i publikut "Okarina e artë", "Akordet e Kosovës", 1987

Në foto: Valentina Saraçini

Nga arkivi personal i Valentina Saraçinit

Edhe ka qenë një befasi e madhe për publikun, ka qenë më shumë befasi edhe për mua, sepse nuk e kam pritur atë sukses të madh. Dhe pastaj, angazhimet kanë qenë shumë të dendura nga ana e Radio-televizionit të Prishtinës, por edhe të Radio-televizionit të Maqedonisë në emisionet e gjuhës shqipe, ku emisione muzikore domethënë, kam qenë shumë, shumë e ftuar, sepse përnjëherësh u bë një popullaritet që unë nuk e prita që do të jetë i tillë.

Unë i kisha orientimet që të vazhdoj fakultetin e Psikologjisë edhe të vazhdoj të jetoj në Shkup. Mirëpo pastaj ndodhin shumë gjëra që ndikuan që unë t'i ndërroj planet e mia jetësore, edhe pse është shumë e natyrshme që në atë fazë të rinisë, në moshën 19

vjeçare njeriu edhe i ndryshon drejtimet apo ambiciet e veta. Por, tek unë kanë ndikuar shumë rrethanat politike. Ndërkohë kanë ndodhur në '81-shin, demonstratat në Kosovë, që kanë pasur kërkesën barazinë e popullit shqiptar të Kosovës me popujt e tjerë edhe avancimin e statusit domethënë qeverisës të Kosovës, që Kosova të marrë, e jo vetëm të jetë pjesë e, si të themi e Federatës si krahinë autonome, që ka pasur dhe të drejtë të vetos, në kuadër të Federatës, por njëherë ka qenë edhe krahinë në kuadër të Republikës së Serbisë. Kështu që kërkesat kanë qenë që statusi të avancohet dhe të jetë republikë. Demonstratat në atë kohë kanë qenë shumë të fuqishme. Ne në Maqedoni jo vetëm si shqiptar, por në përgjithësi mendoj opinionin në ish-Jugosllavi, nuk ka qenë shumë i informuar për atë çka po ndodhte këtu, sepse sigurisht që kanë qenë edhe censurat e forta, sepse ato ishin demonstrata të përgjakshme por ne fillimisht nuk dinim çka po ndodhë.

Asaj kohe unë isha një aktiviste shumë vjeçare e një organizate rinore, që ishte organizatë kulturore, ndërkombëtare, por që ishte si formë e organizimit edhe në ish-Jugosllavi. Domethënë, isha në kryesinë e rinisë muzikore të Maqedonisë, prej vitesh, që në gjimnaz. Tani kur ndodhën këto ngjarjet në Kosovë, shumëçka filloi mënjëherë të reflektohet ndaj qasjes dhe sjelljeve të pushtetit ndaj shqiptarëve. Në radhë parë, për shembull filloi mbas asaj, siç filloi edhe në Kosovë mbas demonstratave, diferencimi ideopolitik, që i largonin edhe nga puna, edhe domethënë... ishte një fushatë e partisë komuniste të Jugosllavisë për t'i cilësuar si armiqësor individët dhe grupet, domethënë ku do që... që kanë pasur lidhje me organizmin, apo edhe s'kanë pasur lidhje me organizimin e demonstratave, por që i kanë përkrahur. Ka qenë një fushatë e diferencimit politik dhe ajo është ndier shumë edhe në Maqedoni. Kështu që aty, unë kur isha në fakultet e ndjeva domethënë që në... nga disa provokime që më janë bo aty nga disa individë, edhe e lash fakultetin atje thash, "Po të mundem diçka me korrespondencë ta vazhdoj se e kisha shumë për qef". Në Prishtinë nuk kishte fakultet të Psikologjisë, asaj kohe. Nuk ishte i hapur, edhe në fakt më ngeli peng ajo gjë. Po meqë kish filluar këtu karriera, dhe e dinja që do të vazhdojë karriera, atëherë më thirrën në punë në Televizionin e Prishtinës, dhe unë u punësova në Televizionin e Prishtinës. Por, shumë interesant që unë punova aty tetë muaj a sa, edhe e shifsha që unë hala s'po më japin vendim. Edhe shkoj i them drejtorit, Agim Zatriqi ka qenë, ndjesë pastë, i them unë, "Pse unë nuk kam vendime?" a din ashtu, "Po, jo kështu, jo ashtu", a din ai disa arsye që, "Do të shofim muajin tjetër, janë disa formalitete", andej, këndej. Por, ai nuk deshte mua të më tregojë, edhe mos, që mos të mërzitem unë, se këtë ma ka treguar më vonë pastaj. Pas shumë vitesh, mbas dekadash. Që në fakt, ata më kishin hapur mu një dosje atje në Maqedoni dhe unë nuk e kam ditur, edhe këtu nuk kanë dhënë pëlqim. Kanë shkuar verifikimet që nuk më është dhënë mua vendimi, që për shkak se nuk kam pasur si të thuash, një rekomandim

pozitiv nga strukturat atje të Maqedonisë, dhe unë nuk kam qenë as në dijeni për këto gjëra.

Ndërkohë u hap konkursi në “Zëri”. Në '82-shin diku në prill më duket se, edhe unë thash vetë me vete “Unë do të konkuroj”, edhe ashtu filloi gazetaria mua të më pëlqej shumë. Sepse aty i shifnja në televizion gazetarët e ashtu edhe më pëlqente kreativiteti edhe kisha një ndjenjë kështu që... kështu popullariteti shkonte në rritje si këngëtare ashtu, por thosha, “Ndale se...” a din si i riu kur është [qeshë], mendonja që, “Ndale se unë kam edhe disa cilësi të tjera që dua t’i dijnë njerëzit” edhe ashtu. Se vërtetë unë isha aktiviste, kisha shumë njohuri, për kulturën, për artin, por kisha edhe që e vogël kam shkruar tregime, kam botuar në gazetën “Pionieri”, “Gëzimi”, në Shkup, “Flaka e Vëllazërimit” i botonte. Edhe kështu që mua më pëlqej gazetaria shumë, edhe ajo dinamika aty në televizion. Por, e pashë që të gjithë a di, flisnin rreth e rrotull, edhe ishin emrat, për shembull, si shkrimtarët tanë të mëdhenjë, poetët, të gjithë që unë i shihnja në Rilindje kur shkonja në naj’ intervistë. Dy herë më ka intervistuar edhe “Kosovarja” edhe “Zëri”, edhe në faqe të parë e, ku e di unë, postera botonin e... edhe unë kur e pashë Pallatin i Rilindjes, ajo ishte domethënë... edhe kur hyshnja aty në ashensor, figurat që ne i kishim mësuar, lektyra kemi pasë, kemi lexuar. “Unë duhet të vij këtu” [përshpëritë] i thash vetes. Pastaj ndodhi ky konkursi edhe unë konkurova. Po them, një nga shkaqet ka qenë ajo sepse ata ende s’më dhanë vendim. Unë nuk ndinja ndonjë siguri. Unë e lash fakultetin, e lash Shkupin. Ateherë konkurova edhe fitova. Ishte testi më i mirë në konkurs. Bashkë me dy kolegë tjerë, edhe ne, tre veta u pranum, edhe unë fillova të punoj në “Zëri”.

Në Rilindje, në katin e parë, ka qenë një byfe e madhe dhe aty ti i shihnje të gjithë njerëzit më të famshëm të gazetarisë në Kosovë. Ndonjeherë edhe më vinte rasti edhe të rri edhe t’i dëgjoj bisedat e më të vjetërve kolegë aty... edhe domethënë ishte ajo ndjenja që të mësosh, përthithnja. Por, edhe dëshira që të tregoj se edhe unë do të bëhem gazetare e mirë edhe e njohur. Dhe fillimisht, aty, ashtu kanë qenë rregullat ligjore që kemi qenë praktikant, pastaj ke marrë titullin bashkëpunëtor i ri, pastaj ke marrë titullin bashkëpunëtor i vjetër, pastaj ke mundur të marrësh titullin redaktor dhe komentator, tash varësisht kush është orientu në çka. Por, këto kanë qenë domethënë kategorizimet.



*Në foto: Valentina Saraçini
Nga arkivi personal i Valentina Saraçinit*

<<< Ambient nga pazari i Prishtinës >>>

Kam filluar prej temave, domethënë, më të thjeshta. Të shkosh në pazar të shikosh si janë artikujt ushqimor. Ta krahasosh me shportën e konsumatorit, "A janë rritë çmimet a s'janë rritur". Pastaj, mbas asaj, pas një kohe, "A e godet kjo standardin, buxhetin e familjeve?". E tani kishte kolegë që më thoshin, "Hë tashi ti do të shkosh në pazar" se unë isha shumë e famshme si këngëtare... edhe ajo dikujt i dukeshte sikur nënçmim. Por unë jo, unë isha e vendosur që unë do ta bëjë prej A-së, do ta mësoj zanatin ashtu si duhet. Edhe kam shkuar në pazar, edhe kam pyetur, "Sa kushton kjo? Sa kushton?". Por, pastaj ngadalë, ngadalë, ambicia ishte shumë e madhe, edhe dëshira e madhe për të kaluar në tema të rëndësishme, edhe më interesonin asaj kohe temat sociale shumë, sepse e ndjeva edhe unë, por, edhe jo vetem unë, por u ndje ajo që ne duheshte përmes këtyre temave sociale të themi se, "Pse është gjendja sociale e rëndë në Kosovë?", "Pse ka kaq varfëri?", "Pse është standardi edhe papunësia kaq ashtu...", dhe këto në sens janë tema politike. Atëherë filluam të godasim në këto... edhe kam bërë disa tema shumë, dhomethënë, që krenohem me to, të asaj kohe. Për shembull, kam qenë një herë në Janjevë, në një fabrikë që punonte do... prodhime edhe të metalit e ku e di unë, edhe shkova atje dhe nuk i kishin... tregonin aty disa punëtorë qysh e ka

pru ai drejtori ku e di unë, një të afërme të vetën, edhe unë e bëra temën që, “Uzurpimi i të drejtave”. Domethënë, se të tjerët që kanë pasë të drejtë që të punësohen s’janë punësu, edhe pastaj, e bëri një ilustrim, ka qenë, e kemi pasur në redaksi Salih Hutolli, ka qenë artist, po ai i ilustronte disa ashtu...e bëri një ilustrim. Një grep kështu si të peshkatarit qysh po ja merr të drejtat punëtorëve, ky drejtori. Edhe ajo ishte shumë temë e guximshme për atëhere edhe bëri shumë bujë. Aq bujë bëri sa ai drejtori pastaj kishte thirrur kryeredaktorin kish thënë, “Ajo nuk mundet më të shkelë aty” a din, ky i ka thënë “Urno”, a din, “Qysh s’mundet ajo?”, domethënë, “I ndalohet hyrja aty”. Edhe ka qenë shumë e vështirë të mbërrish t’i tejkalosh, është dashur shumë punë.



*Në foto: nga e majta në të djathtë, Valentina Saraçini, Qani Mehmedi (redaktor) Gani Dili (kryeredaktor) dhe Hakif Bajrami (historian), 1985
Nga arkivi personal i Valentina Saraçinit*

Ajo çka mua më kujtohet shumë mirë, domethënë ajo ndjenja se si neve na kanë mësuar domethënë redaktorët, na kanë udhëzuar, sepse edhe situatat, prapë po kthehem, kanë qenë shumë delikate, për shkak të atij diferencimit ideopolitik. Mbas '81-shit ka qenë shumë e vështirë... edhe për gazetarët me shumë përvojë, se le më për neve që ishim më të ri. Kështu që, asaj kohe filloi me të madhe të ndjehet cenzura. Domethënë, shkonte gjerë aty për shembull, që me disa vendime, ose me udhëzime... me vendime, ato ishin qëndrime të partisë komuniste, të, qoftë të Komitetit Qendror të Jugosllavisë a, të Serbisë a, të Komitetit Krahinor që i thoshin të Kosovës. Deri aty sa thuheshte që, “Duhet këto, këto tema të rrahen, këto, këto...” a din, edhe imponohej.

Shumë gjana imponoheshin... edhe pastaj ekzistonte edhe auto-cenzura. Por, që ta bësh auto-cenzurën duheshte të kesh shumë domethënë... prapë kishe dëshirë që të thush diçka, mirëpo, prapë duheshte të kesh kujdes se mos e kalosh limitin. Edhe pse për ne që ishim më të ri, domethënë ne ishim pak si më rehat, shkaku barrën më të madhe e kanë pasur redaktorët, sepse ata e merrnin përgjegjësinë. Redaktori dhe kryeredaktori e merrte përgjegjësinë nëse del një tekst që, domethënë binte në ndesh me qëndrimet politike që i propagonte partia komuniste. Kështu që, por, megjithatë unë e mbaj në mend që unë e kam pasë fatin që kam pasë redaktor Qani Mehmedin, dhe ai domethënë edhe vete ka qenë një nga gazetarët e guximshëm. Por, ai më thoshte, "Kur të arrini që ju të rinjtë, kur të arrini që unë të ju heq diçka, atëherë jeni bo gazetarë të mirë, se e keni thënë shumë guximshëm" ose, a din, e jo ta shkruash veç.... Kështu që ajo u krijua... ajo ndjenja që... dëshira që gjithmonë të themi diçka më shumë se sa që lejohet. Por, ishim të vetëdijshëm që duhet ta themi në atë mënyrë që të mos jetë edhe aq e hapur. Haptazi, që të mund të ndikonte, për shembull, që, ose të të largojnë nga puna, ose... fillimisht të largonin nga partia, pastaj të largonin nga puna.

Kështu që megjithatë, megjithatë, asaj kohe filloi ajo ndjenja e përgjithshme, edhe në Rilindje, po edhe në institucionet tjera, që të rezistohet. Aty filloi rezistenca do të thotë. Nuk u ndal asnjëherë. Ato... vërtetë demonstratat u shuan, përgjakshëm, edhe u vranë demonstrues, edhe u burgosën me qindra të rinjë që ishin, qoftë organizatorë, qoftë pjesëmarrës të demonstratave. Por, një rezistencë edhe një ideal për Republikën e Kosovës, e për pavarësinë e Kosovës, nuk u shua asnjëherë. Vetëm rrethanat dhe forca diktonte mënyrat se si do ta bësh atë rezistencë. Kështu që, Rilindja kujtoj unë, por jo vetëm Rilindja, edhe Radio-televizioni i Prishtinës; Por, Rilindja megjithatë ka pasë... ka qenë si të them, si prijëtare. Ka bërë... filloi atë rezistencën, edhe ajo kulmoi pastaj me... në vitin 80 e... qysh në vitin '88 kur filluan ndryshimet kushtetuse që Serbia i deshti t'i imponojë. Atëherë filluan me... kur ishte pastaj dorëzimi i librezave të partisë masovikisht, edhe ndër të parët kanë qenë gazetarët, redaktorët e Rilindjes që kanë... dhe punonjësit e tjerë, që i kanë dorëzu, domethënë i kanë bojkotu librezat partiake. E domethënë, të gjithë kemi qenë në një motiv, për të bërë sa më shumë tema të guximshme. Mundësisht sa më të guximshme për... që shkojnë në favor të atij ideali, të kontributit për të arritur domethënë, ta kundërshtojmë, ta rezistojmë regjimin pushtues, që po shiheshte që po ashtu... sepse ne ishim në njëfarë mënyre që atëherë të pushtuar, edhe në këtë ideal domethënë kemi pasur shumë, shumë, marrëdhënie të mira kolegiale, miqësore.

Domethënë, unë e mbaj në mend që krejt, domethënë, krejt kohën, ndonjëherë edhe kohën e lirë ti e kalonje me njerëzit të cilët punon... edhe çka më mungon mua nga kjo kohë, më mungon pikërisht kjo. Domethënë një kolegialitet, një solidaritet, një vlerësim një... domethënë edhe atëherë ka pasur nga pak xheloz, e ka pasur pak rivalitet e ashtu

por, nuk kanë qenë domethënë në nivelin që ti i sheh sot. Njerëzit kanë ditur të të vlerësojnë, kanë ditur të të japin, si të thuash komplimente. Ka qenë një emision që e kemi bërë në Televizionin e Prishtinës, e më patën thirrë mua që të debatoj bash në emisionin ku unë përpara kam punuar në “Ritmet rinore”, edhe kemi qenë atje, edhe domethënë kemi folur me një emision shumë i guximshëm. Kemi folur haptazi për atë çka nuk shkon, edhe që nuk është mirë që po ndodhë, edhe që rinia edhe shqiptarët duhet të jenë të barabartë. Edhe kanë qenë edhe disa sërëb që kanë folur aty kështu që, ka qenë një emision jashtëzakonisht i guximshëm... edhe kam përjetuar që për shembull, të nesërmen kur kam shku në Rilindje vinjin njerëzit, domethënë njerëzit vijshin, kolegë të ndryshëm, edhe nga revistat edhe nga Rilindja, vinin në “Zëri” dhe na komplimentonin për... domethënë për guximin edhe për atë çka kam thënë në emision, në Televizion të Prishtinës. Këto më mungojnë shumë, sepse sot ka konkurrencë shumë, por, ka edhe mungesë të etikës profesionale dhe kolegjiale. Se shiko, edhe marrëdhënjet kolegjiale ndër-njerëzore kanë një lloj etike, e këto më mungojnë tani.

Edhe mungon, mbi t’gjitha në mediat sot, mungon ai thelbi i të bërit gazetari në interes të qytetarëve dhe të shtetit dhe të lirisë. Sepse ne ende nuk e kemi përfunduar tërësisht. Nuk e kemi rrumbullakësuar tërësisht shtetësinë, sovranitetin, edhe ende jemi domethënë në një luftë politike. Tash është luftë politike më shumë, por që, vazhdimisht vinë momente kur kërcënohet edhe integriteti, domethënë ka përpjekje nga Serbia të kërcënojë edhe integritetin territorial. Edhe tashti kjo lufta e pluralizmit politik, lufta e partive politike për pushtet, edhe një... si të them, përkatësie partiake e heshtur, ose e hapur e pjesës më të madhe të mediumeve, e cënon në thelb interesin e qytetarëve, të lirisë, të shtetësisë dhe pavarësisë të vendit. Kjo më dhemb, shumë... edhe kjo ma forcon edhe më shumë atë nostalgjinë për atë ndjenjën e idealit dhe unitetit që kemi pasur atëherë kur filloi ajo rezistencë. Kur të gjithë, domethënë qëllimin kryesor dhe të vetëm e kishim... gjithçka ishte sekondare, dytësore. Prioritet edhe parësore ishte si t’bëjmë gazetari, si t’bëjmë tema, si ta përkrahim njëri tjetrin, si të bëjmë tema sa më të guximshme që të shkojnë në favor të artikullimit të idealit dhe të aspiratës së popullit për liri dhe pavarësi.